

Koment lidhur me koncept dokumentin për trajtimin e procedurave të inkasimit të detyrimeve doganore për telefonat mobil.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e më tutjeshëm Agjencia) me datën 06.03.2015 ka pranuar një kërkesë me nr. Prot. 19/2015 nga Dogana e Kosovës (në tekstin e më tutjeshëm Dogana) konkretisht nga sektori për çështje legjislative dhe ligjore, ku ka kërkuar:

Koment lidhur me koncept dokumentin për trajtimin e procedurave të inkasimit të detyrimeve doganore për telefonat mobil.

Në Republikën e Kosovës e Drejta e Privatësisë është e drejtë e garantuar me Kushtetutë, Marrëveshje dhe instrumente Ndërkombëtare dhe me Ligjin Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e më tutjeshëm LMDHP).

Kjo e drejtë, e garantuar me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e më tutjeshëm KRK), përfshin respektimin e jetës private dhe familjare, pacenueshmërinë e banesës, fshehtësinë e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimeve të tjera, dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

E **dhënë personale** sipas nenit 2 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.1) të LMDHP-së është çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikueshëm (subjekt i të dhënave) i cili mund të identifikohet në mënyrë **të drejtpërdrejt** ose **të tërthortë**, në veçanti në bazë të një ose më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij ose saj fizik, psikologjik, mendor , ekonomik, kulturor ose shoqëror.

International Mobile Equipment Identity (IMEI) është shifër unike identifikuese internacionale e pajisjes komunikuese mobile. Nuk ka dy pajisje komunikuese mobile të cilëve ju vendoset e njëjta IMEI gjatë prodhimit.

Bazuar në ligjin Nr. 04/L-109 për Komunikimi Elektronike, ndërmarrësit të cilët ofrojnë rrjeta të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbime duhet të sigurojnë që të ruhen kategoritë e të dhënave në mesin e të cilave është emir, mbiemri si dhe IMEI. Subjekti i të dhënave identifikohet me një numër unik siç është IMEI dhe si rrjedhojë, sipas LMDHP-së IMEI cilësohen si e **dhëna personale**.

Sipas Working Party 29 - Opinionit 02/2013 mbi aplikacionet në pajisjet e mençura, të miratuar më 27 shkurt 2013: "Pajisjet fundore të shfrytëzuesve të rrjeteve të komunikimeve elektronike (celularët) dhe çdo informacion i ruajtur në pajisje të tilla janë pjesë e sferës private të përdoruesit që kërkojnë mbrojtje sipas konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Këto informata janë të dhënat personale çdo herë që ato lidhen me një individ, i cili është drejtpërdrejt ose tërthorazi i identifikueshëm tek kontrolluesi ose të një pale të tretë"¹.

¹ Working Party 29 - Opinion 02/2013 on apps on smart device, Adopted on 27 February 2013

Gjykata Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr.57 të datës 05.12.2014, ka konsideruar se “numri IMEI i aparatit celular përbën **të dhënë me karakter personal** dhe askush nuk është i detyruar të bëjë publike këtë të dhënë, përveç rasteve të parashikuara në ligj.”

I. Sqarim lidhur me opsionin 4.2 të koncept dokumentit :

1)Amandamentimit të Ligjit për Komunikime Elektronike dhe

2)Nxjerrjes së Ligjit të veçantë: Ligjit për procedurat e inkasimit të detyrimeve doganore për telefonat celular (mobil)

Arkitektura e rrjeteve celulare përcakton që pajisja mobile duhet të kyçet në celulën më të afërt. Kjo mundëson zbulimin e vendndodhjes së pajisjes mobile varësisht se në cilën celulë është kyçur. Rreziqet në lidhjet me cenimin e privatësisë mund të jenë të mëdha pasi që përmes IMEI mund të zbulohet vendndodhja (lokacioni) i/e personit në kohë reale, mund të zbulohet se ku ka qenë personi në një kohë të caktuar: në cilën rrugë, në cilin qytet etj., ruajtja për kohë më të gjatë nxjerr në pah historinë e lokacioneve të personit, nga krahasimi i IMEI-ve mund të arrihet në përfundim se cilët persona kanë qenë afër njëri tjetrit fizikisht, rreziku i posedimit të IMEI nga personat e paautorizuar mund të përdoret për të zbuluar lokacionin e personit, kombinimi me të dhënat tjera që i ruajnë operatorët e telefonive mobile nxjerr informata tjera si kohën e preferuar për komunikim, kohën kur personi pushon, kohën kur punon, kur preferon të flasë në telefon, kur preferon të komunikoj me mesazhe etj. Me posedimin e të gjitha informacioneve të mësipërme shumë lehtë mund të realizojmë një profilizim të subjektit të të dhënave.

Rreziku është akoma më i madh kur kombinohet tërësia e të dhënave pa përlllogaritur siç duhet mbrojtjen e të dhënave dhe qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar.

Parandalimi i krijimit të “profilizimit të personalitetit”, ka qenë një ndër qëllimet kryesore të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale që nga fillimi. Arsyeja prapa ligjit për mbrojtjen e të dhënave, si një formë e re e mbrojtjes së jetës private, është se të dhënat që janë konsideruar më parë të padëmshme apo të parëndësishme, mund të jenë të rrezikshëm për jetën private të qytetarëve nëse kombinohet dhe përpunohen duke përdorur teknologji moderne.

Profilizimi mund ta sfidojë thelbin e demokracisë sepse rolin e njerëzve në procesin e vendimmarrjes e zhvendosë në prapavijë, si dhe krijon shpërndarje të pa balancuar të pushtetit dhe asimetri të dijes midis qytetarëve në njërin anë dhe qeverisë e ndërmarrjeve biznesore korporativiste në anën tjetër².

Në këtë rast çdo herë kur profilizimi realizohet pa një bazë ligjore apo mos dhënies së pëlqimit nga ana e subjektit të të dhënave është në kundërshtim me parimin bazë të mbrojtjes së të dhënave personale i cili përcakton se përpunimi i të dhënave personale nuk duhet të jetë i njëanshëm.

Pasi që IMEI mund të klonohet (falsifikohet), atëherë përdorimi i tij si identifikues i pajisjes mobile është i gabueshëm. Falsifikimi mund të bëhet duke transmetuar tjetër IMEI nga IMEI i vërtet që ka pajisja mobile. Kjo e bën sfiduese bllokimin e IMEI nga operatorët sepse nga dhjetë

² The impact of profiling on fundamental rights V. Ferraris (AMAPOLA); F. Bosco, E. D’Angelo (UNICRI) Internal reviewer: B.J. Koops (Tilburg University)

IMEI të njëjte nuk mund të dihet cili është origjinali dhe cili duhet të bllokohet e cili duhet të lejohet.

Në përgjithësi, autoritetet kanë qenë të fokusuar në eksplorimin e masave teknike dhe rregullative për të ndaluar kriminelët që të manipulojnë me pajisjet e telefonisë mobile, pra të regjistrohen telefonat e humbur apo vjedhur në një regjistër, por klonimi i IMEI e ka vështirësuar funksionimin e drejtë të këtij regjistri dhe është vërejtur një rritje e madhe e kësaj dukurie.

Agjencia me rastin e shqyrtimit të koncept dokumentit ka marr në konsideratë edhe praktikën rajonale dhe evropiane të trajtimit të IMEI.

Gjykata Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr.57 të datës 05.12.2014, ka konsideruar se "numri IMEI i aparatit celular përbën të dhënë me karakter personal dhe askush nuk është i detyruar të bëjë publike këtë të dhënë, përveç rasteve të parashikuara në ligj. Nëse për arsye të mbrojtjes së interesit publik apo të të drejtave të të tjerëve është i nevojshëm kufizimi i kësaj të drejte, ai mund të vendoset vetëm me ligj" ku me këtë vendim ka **anulluar** vendimin e Qeverisë për ngritjen e bazës të të dhënave IMEI dhe regjistrimin e numrave IMEI të aparateve celulare që përdoren në rrjetet e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme.

Direktiva 2006/24/EC e BE-së për ruajtjen e të dhënave të gjeneruara apo të përpunuara në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike në dispozicion për komunikimin elektronik ose rrjetet e komunikimit publik dhe me ndryshimin e Direktivës 2002/58 / EC ("Direktiva për ruajtjen e të dhënave"), kanë paraparë ruajtje të detyrueshme të të dhënave të trafikut që kanë të bëjnë me numrat telefonik fikse dhe mobil, qasjen në Internet, email dhe telefonia nga ana e shteteve anëtare. Këto të dhëna, sipas ligjvënësimit evropian, janë të domosdoshme që të identifikohet burimi, destinacioni, data, koha, kohëzgjatja, lloji, pajisja dhe vendndodhja e komunikimit; periudha e ruajtjes gjithashtu është përcaktuar nga Direktiva: "jo më pak se 6 muaj". Qëllimi i ruajtjes së të dhënave është "që të sigurohet që të dhënat janë në dispozicion për qëllime të hetimit, zbulimit dhe ndjekjes penale **të krimeve të rënda**". Ruajtja e të dhënave me qëllim të lejimit autoriteteve kompetente nacionale të kenë qasje të mundshme në këto të dhëna, vërtet të përmbush një objektiv të interesit të përgjithshëm nëse është në pyetje hetimi, zbulimi dhe ndjekja e krimeve të rënda.

Direktiva "mbulon, në përgjithësi, të gjithë personat dhe të gjitha mjetet e komunikimit elektronik si dhe të gjitha të dhënave e trafikut, pa asnjë dallim, kufizim ose përjashtim që bëhet nën dritën e objektivit të luftës kundër krimeve të rënda", dhe "zbatohet bile edhe për personat të cilët nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të sugjeruar që sjellja e tyre mund të ketë lidhje, tërthorazi apo nga larg, me krimet e rënda". Tutje, Direktiva nuk kërkon ndonjë marrëdhënie në mes të të dhënave, ruajtja e të cilave është siguruar për dhe si kërcënim për sigurinë publike dhe, në veçanti, nuk është e kufizuar në ndonjë ruajtje në raport (i) me të dhënat që kanë të bëjnë me një periudhë të veçantë dhe/apo zone të veçantë gjeografike dhe/ose në një rreth të personave të caktuar ka ngjarë të jenë të përfshirë, në një mënyrë apo tjetrën, në ndonjë krim të rëndë"

Proporcionaliteti është një parim themelor i së drejtës evropiane për mbrojtjen e të dhënave. Gjykata Evropiane e Drejtësisë (Vendimi në rastin e bashkuar C-293/12 and C-594/12) ka gjetur se **"legjislacioni i BE-së i ka tejkaluar kufijtë e imponuar nga pajtueshmëria e parimit të proporcionalitetit"** dhe vlerësohet që Direktiva është e **pavlefshme**.

Agjencia konsideron se plani i regjistrimit të detyrueshëm të numrave IMEI për të siguruar përputhshmërinë me detyrimet doganore do të përfshijë qëllimet, të cilat janë më pak të rëndësishme për funksionimin e shtetit dhe konsideron se është një shkelje edhe më të rëndë të parimit të proporcionalitetit se sa projekti për ruajtje të të dhënave të BE-së. Së pari, në rastin e Doganës, ndërhyrje në jetën private të qytetarëve do të jetë po aq i rëndë si në rastin e BE-së, që regjistri do të përmbaj të gjitha të dhënat e personave që përdorin telefonat celularë, duke përfshirë edhe ata të cilët nuk janë të përfshirë në ndonjë krim të rëndë. Së dyti, qëllimi i mbajtjen e numrave IMEI nuk shërben për të luftuar krimet e rënda. Rrjedhimisht, kjo masë do të ishte edhe më pak proporcional se dispozitat e Direktivës për ruajtjen e të dhënave, të anuluar nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë.

Nga shtetet anëtare të BE-së nuk kërkohet të bëhet ndonjë regjistrim i domosdoshëm i numrave të IMEI nga ana e përdoruesve. Është me rëndësi të theksohen se në kuadër të shteteve të BE-së dhe ato rajonale kemi iniciativa për heqjen e çmimet për roaming dhe krijimit të një tregu të brendshëm evropian apo edhe rajonal. Duke ditur se edhe Kosova do të jetë pjesë e këtyre iniciativave rajonale atëherë del që zbatimi i projektit për regjistrimin e IMEI do të jetë i vështirë dhe mbase i pamundur.

Bazuar në praktikat evropiane dhe botërore çështja e telefonave të humbur apo të vjedhur mund të zgjidhet me përdorimin e bazës ekzistuese të të dhënave GSMA CEIR.

Nga ajo që u tha më lartë, mundë të konkludojmë që masat e tillë do të jenë në disproporcion me interesin thelbësor publik dhe tejkalon kufijtë e lejuar nga pajtueshmëria e parimit të proporcionalitetit duke shkelur të drejtën e privatësisë dhe të drejtën e të dhënave personale. Në rastin konkret privatësia është më me interes se sa inkasimi i detyrimeve doganore për telefonat celular e cila mund të realizohet edhe me metoda tjera.

II.Sqarim lidhur me opsionin 4.2 të koncept dokumentit :

3) Që përmes politikave strategjike Ministria e Zhvillimit Ekonomik si një nga organet kompetente në fushën e komunikimeve elektronike në referim të nenit 7 të LKE-së harton dhe nxjerr akte nën-ligjore me qëllim të zgjedhjes së çështjes.

Qasja në këto të dhëna (IMEI) në mënyrë të drejtpërdrejt apo tërthorazi ndikon në jetën private dhe me këtë në të drejtat e garantuara me nenin 36 (paragrafi 4) i KKK-së ku secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja ruajtja, qasja korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj. Trajtimi i kësaj çështje me akt nënligjor është në kundërshtim me KKK si dhe me LMDHP.